



# KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

## TRANSKRIPTI

### DEÇANI

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VII-ë , mbledhja e I-rë në vitin 2024 ) me dt.31.01.2024



DEÇAN

## Kuvendi I Komunës së Deçanit

01.Nr.I.

Deçan, dt.31.01.2024

# Transkript

I mbajtur për mbledhjen e I-rë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Deçanit, me dt.31.01.2024.  
Në mbledhje merrnin pjesë: 26 anëtar të Kuvendit (mungon Teuta Neziraj), gjashtë drejtor të drejtorive komunale, Shefja e kabinetit të Kryetrit, Manjolla Shala, OJQ (Adem Lushaj)

Mbledhjen e kryesoj dhe udhëhoqi, Kryesuesi I Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

**Kryesuesi, z.Hajdar Sutaj** – e hapi mbledhjen e pare të rregullt të kuvendit për vitin 2024 duke I përshëndetë të pranishmit, pastaj thotë se sipas nënshkrimeve në listë, kemi kuorum të mjaftueshëm sa i përket punimeve, meqë nga 27 anëtarët e kuvendit 26 janë prezent. Konstatoj se nga lista e shkrimeve kemi kuorum të mjaftueshëm për me vazhdu me punimet e mbledhjes së par të kuvendit të komunës për vitin 2024. Ashtu siç e keni mar edhe materialin për këtë takim, propozoi këtë rend pune.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2 shqyrtimi i raportit 1 vjeçar të kryetarit të komunës.

3 shqyrtimi i raportit analitik financiar për vitin 2023.

4 shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës së kuvendit për vitin 2024.

5.Marrja vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhje publike të kuvendit, si dhe mbledhjeve të KPFS për vitin 2024.

6.Marrja e vendimit për ndarjen e parcelave për ndërtimin e 3 çerdheve për fëmijë në fshatin Gramaçel, isniq dhe strelle i epërm.

7. Marrja e vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për kontingjentin e tretë me lopë qumështore. Marrëveshja dhe aneks marrëveshja me OZHR “Mëshqerra”.

8. Ndryshimi dhe Plotësimi i Komitetit të Komuniteteve ,

9.Të ndryshmet.

Kryesuesi ka thënë se në të Ndryshme e kemi 1 kërkesë, e cila ka ardhur, me kërkesën e Ministrisë për kulturë, rini dhe sport. Marrja e vendimit për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e pishinës, gjysëm Olimpikë, materialin e të cilës e keni marrë sot. Të nderuar koleg, nëse ka dikush diçka me diskutu ose më e komentuar ja kalojmë fjalën. Ju zotëri, mos sulmoni. Kështu para se me diskutua. ju njoftoj që platforma për transkriptin është aktive. Edhe ju lus qe mos me diskutu para se të ndezet mikrofonin sepse nuk keni zë. Edhe respektoni fjalën i tjetrit, sepse veç ai që ka mikrofonin dhe folë me emrin e tij regjistrohen.

## Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues përshëndetje për ju drejtorët dhe kolegët. Rreth rendit të punës propozohet të ndryshohet pika 2 dhe 3 renditje me pikën 4 dhe 5, sepse kështu është rregulli, së pari duhet të miratohet plani i punës së kuvendit dhe marrja e vendimit për mbledhje të rregullta të kuvendit, e pastaj të vazhdohet me pikat e tjera të parapara. Nuk ka kuptim të trajtohet pikë të tjera pa aprovu të 2 pikat e cekura më lart. Ditë më parë, kuvendi ka mbajtur 1 punëtori pikërisht për planin e punës së kuvendit në Durrës. Dua te ishin prezent edhe

kryetari i komunës dhe ekzekutivi sepse ai plan e parasheh shumë qartë renditjen e pikave për mbledhjen e sotme. Ta ndryshosh komplet planin e punës të paraparë, për janar nuk e kuptoj se duhet bëhet kjo shkelje. Kjo i bjen sikur ta ndërtohet 1 shtëpi pa themel. Andaj unë e kisha propozuar që pika 4 dhe 5, të renditen në pikën 3 dhe 3 e kështu që të miratohet rendi i ditës.

### **Kryesuesi, Hajdar Sutaj**

E hudhi në votim propozimin e Mon Selmonaj për ndryshimin e renditjes së pikave të rendit të ditës, në vazhdim konstaton se nuk ka kaluar propozimi. Kryesuesi në vazhdim e qiti në votim rendin e punës të propozuar me ftesë, rend dite I cili miratohet me 16 vota për dhe 10 apstenim.

I.Shqyrtimi dhe miratimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

### **Mon Selmanaj**

Në faqen e fundit të procesverbalit aty ku flitet për investitorin, i cili ka ofruar shumën 1,442,500.00 €, të përmirësohet, jo siç është në procesverbal shuma për mbi 40 milionë euro.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë. Është gabim teknik dhe duhet përmirësu, në vazhdim e qiti në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar, I cili miratohet njëzëri me korigjimin të fjala e Mon Selmonaj në faq. E fundit shuma “ prej mbi 40 million € zëvendësohet me shumën 1,442,500.00€”.

## **II. shqyrtimi i raportit 1 vjeçar të kryetarit të komunës.**

Kryesuesi e ka prezentu piken pastaj ka sqaruar kryetari I komunës ka takime sot në Qeverinë e Republikës së Kosovës me ministrat e dikastereve të ndryshme dhe e ka autorizuar Nënkryetarin, i cili besoj që është këtu, mirë po i kemi dhe drejtorët e drejtorive për të dhënë sqarime. Në vazhdim e hapi diskutimin për grupin e AAK-së fjala.

### **Arjan Dobraj**

Faleminderit kryesues i nderuar Sutaj, të nderuar anëtarë të ekzekutivit, të nderuar kolegë dhe kolege asamblast. Raporti i kryetarit kemi thënë edhe herën e kaluar që ka disa mangësi Shpresojmë dhe pritet me u përmirësu unë e kom ni vërejtje që e kom bo ma kryesoren, që e shoh si diçka të parregullt dhe nuk është rregull realisht që mu shfaq disa emra që i kom pa këtu që disa flet të raportit. Sepse u duket se janë kërkesa personale, dhe nuk ka nevojë pse mu shfaq te raporti i kryetarit. Kemi thënë edhe më herët, po e them edhe prap që është mirë që mu hek. Domethonë prej faqe, 18. Nuk u duket diçka si normale, Ishin mirë se duhet mu hek këtë lloj të dhënash, sepse duhet të mbeten personale. Unë diçka tjetër nuk kam.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit z.Dobraj, tash Hyri Dobrunaj nga LDK-ja e ka fjalën.

### **Hyrije Dobrunaj**

Grupi parlamentar i LDK-së mendon që raporti 1 vjeçar i punës së kryetarit është mjaftueshëm i rëndësishëm, bile bile osht ndër raportet e ma të rëndësishme dhe që kryetari nuk është prezent. Na kemi pyetje, unë kam pyetje, mirëpo nuk mundem me i pytë drejtorët sepse ti e din kryesues, e kemi diskutuar edhe në KPF, se kryetari ka thënë unë përgjigjem për drejtor, kështu që nuk është e udhës fare me shqyrtu raportin 1 vjeçar të kryetarit, në qoftë se ai nuk është prezent, mundemi me e shty. Ky nuk është diçka që osht urgjent. Ky është

diçka që mundet me pritë për mbledhjen e ardhshme. Unë propozoj që ky raport me u shty për mbledhjen e radhës meqenëse Kryetari nuk është prezent.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë, Realisht nuk është Kryetari, por nënkryetari po, kanë të drejtë dhe drejtorat për me për me diskutu edhe mu përgjigj drejtorët kanë drejtë kur kryetari nuk është present, përgjigj çdo njëri nga drejtorët për drejtorinë evet.

### **Faton Selmanaj**

Përsëritje kryesues, përsëritje kolegë. Faleminderit për fjalën. Unë kam disa pyetje, por meqenëse nuk është kryetari, edhe unë ndaj të njëjtin mendim me kolegen Hyrije që mos të diskutohet fare për këtë raport. Sepse shihet që këtu ka çështje të ndryshme dhe pyetje tjera, kështu që mendoj që duhet të shtyhet për një seancë tjetër, përderisa sot kryetari mungon.

### **Mon Selmonaj**

Unë kam shumë çka. Po meqenëse kryetari është këtu, të gjitha adresimi im shkon kot. Megjithatë unë kam përgatit fjalimin tim për këtë pikë. E shfrytëzoj rastin ta paraqes para jush para kolegëve. Edhe pse e di që propozimet e kolegëve paraprak, Kjo pikë do të hasi në kundërshtim nga mazhoranca, ashtu që, po shfrytëzoj rastin të flas. Të nderuar kolegë. I vlerësoj angazhimet dhe përkushtimet e kryetarit dhe zyrës së kryetarit për të përmbushur 1 obligim ligjor, siç është raporti i punës për vitin 2023. Si dokument voluminoz ky raport na paraqet deri detajet më të hollësishme të të gjitha aktiviteteve tuaja këtu, kur them tuaja nënkupton me punën e kryetarit dhe sektorëve të tjerë në kuadër të komunës. Nga të dhënat e përshkruara në faqen 6, ku flitet për nënshkrimin e 32 kontratave publike, ne kemi hasur në 7 prej tyre që janë 2 herë të evidentuara. Ndërsa kisha lutë drejtoreshën e financave apo kushdo tjetër le të përgjigjet në vend të kryetarit. Nëse i largojmë këtu na mbetin 25 kontrata të nënshkruara që në fakt nuk janë në proporcion me numrin e deklaruar të 32 të tilla. Tani shtrohet pyetja ku mbeten edhe 7-të projekte tjera, apo ky është 1 kamuflim për ata që nuk janë të vëmendshëm gjatë leximit? Zyra e auditorit të brendshëm nga numri i rekomandimeve në raport në raportet e auditimit në pikën 3,37 faqe 8. Na jepen të dhëna për numrin e rekomandimeve të bazuara që janë. Pyetja ime është zoti kryetar pse asnjë nga njësitë e audituara nuk ka përpiluar planin e implementimit të rekomandimeve. Dhe a do të vepronin kuadër të kompetencave ligjore që kjo neglizhencë e papërgjegjësi të përmirësohet. Në raportin e performancës të publikuar ditë më parë nga MAPL, komuna jonë renditet pothuajse në fund. Në fjalën hyrëse të këtij raporti, zoti kryetar, ju jeni shprehur citoj: “jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë në nivelin më të lartë të transparencës komunale” Ky deklaram juaj bie ndesh me raportin e ministrisë së administratës. Kur kësaj i shtojmë edhe raportin e auditorit të jashtëm me të gjeturat dhe rekomandimet për vitin 2023. Na bën kurioz të dimë zoti kryetar se cilat janë vlerësimet tuaja për të përmirësuar dhe ngritur nivelin e transparencës në nivelin e duhur. Se vetëm në 2 drejtori atë të shëndetësisë dhe arsimit kam hasur të flitet për performancën dhe ngritjen e saj.

### **Hajdar Sutaj**

Thotë që e patën diskutimin edhe shefi i grupit të LDK- së propozoj që me shty raportin na veç e kemi votu si pike të rendit të ditës, mirëpo mundemi mi pyet edhe një herë kuvendin, kush është për me shty? me 16 vota për diskutimin e raportit sot në këtë mbledhje dhe 10 vota kundër, diskutohet sot raporti i kryetarit dhe nuk shtyhet.

**Manjolla Shala, Shefe e kabinetit të kryetarit, përgjigjet në çështjet e ngritura, në mungesë të kryetarit.**

Atëherë përshëndetje për të gjithë, iu përgjigj pyetjes së qe beni komentit Arjan Dobra, Tek raporti i zyrës së personelit apo zyrës për burime njerëzore është i publikuar edhe në faqen e komunës. Pra nuk janë personale, janë publike. Këtu janë 32 kontrata publike që janë të nënshkrueme dhe janë të të gjitha. Janë të shkruara. Këto ka mundësi që ka qenë ndonjë projekt të shkruar 2 herë se ka qenë, Ose nëse ka ndodhur si gabim teknik e rregullojmë.

### **Mon Selmonaj**

Unë besoj se të gjithë e kemi raportin e kryetarit përpara. Atëherë faqen 6. ju lutem shikoni. I kemi projektet që jam 2 herë të evidentuara e ato janë renovimi i objektit zjarrfikësve, rekonstruimi i rrugës së bjeshkës të Belegut, punë shtesë, fasadimit dhe punë të tjera në qendrën rinore në Deçan, ndërtimi i trotuarit, komunën e Deçanit, ndërtimi i rrugës qendrore, Deçan kolonia e artistëve, faza e 2-të e të gjitha këto që i ceka janë 2 herë të përfshime si projekte në këtë raport. Prandaj cilat janë ato 7 kontrata publike të cilat nuk i përfshin në këtë raport? Që ish dashtë përfshihen.

### **Manjolla Shala**

Atëherë falemnderit shumë unë e kom përgatit raportin, edhe ka qenë gabim i emrit që unë e besoj se nuk e kom shkru, unë kam me ba përmirësimin e kësaj faqe. Ata që thatë për raportin e performancës, raport i performancës që është publiku ka qenë për vitin 2022. Ky raport është për vitin 2023, raport i performancës për vitin 2023 nuk është publikuar ende. E kështu që këto që ka thënë kryetari në fillim nuk bie ndesh me atë që është shkru këtu.

### **Vatan Istrefaj**

Po atëherë falënderit kryesues përshëndetje për të gjithë. Sa i përket raportin njëvjeçar të punës së kryetarit, atëherë, pra nëse do të vazhdojmë me fjalimin e tij, ndaj unë kam për të folur vetëm për transparencën komunale, e cila tregon më së miri qeverisje komunale. Kjo pra është e dhimbshme që komuna e Deçanit është radhitur, komuna e 27 me radhë, pra të nderuar ekzekutiv komunal. Kjo nuk është qeverisje që meritojnë qytetarët e Deçanit. Pasi qe mostransparenca komunale tregon 1 qeverisje jo te pastër dhe se nuk është në favor të qytetarëve. Por po ashtu për shkak të keq-qeverisjes komuna jonë nuk ka qenë asnjë herë përfituese e grantit për performancë komunale.

### **Kryesuesi I Kuvendit, Hajdar Sutaj**

Faleminderit shumë, a ki me shtu diçka, Manjollë?

### **Manjolla Shala**

Ashtu siç thashë, raporti performancës siç është publiku ka qenë për vitin 2022, jo për vitin 2023 ky raport, por ky raport është për vitin 2023. Nëse keni diçka për vitin 2023.

### **Hyri Dobrunaj**

Meqenëse që u votu për me u diskutua sot raporti, kryetari nuk qenka këtu, thatë që i ka deleguar kompetencat te Nënkryetari, por as aj nuk qenka. Do të thotë kompetencat a I ka delegu te dikush tjetër nuk e di, por ajo shumë pak ka rëndësi, krejt qe po du me thon janë pyetjet me bazë, sepse nuk mundë të përgjigjet dikush i cili nuk është përgjegjës për tu përgjigjë. Por sa i përket Info raporti i progresit komunave, sa i përket komunës Deçanit e cilëson komunën e Deçanit si të papërmirësueshme në aspektin e prokurimit. Këte e tregon edhe kjo lista që keni paraqitur me projekte sepse kjo absolutisht nuk përputhet as me projektet kapitale të komunës

për viti 2023, të cilat ju vetë I keni pasur dhe i keni shfaqur. Kaq mjafton për këtë raport, sepse kur ju nuk jeni kompetent dhe nuk I kini as përgjigjet.

**Hajdar Sutaj - mbetur tek 00:20:05 – 00:20:09**

Falënderit shume, znj. Dobrunaj, dikush tjetër? Atëherë i mbylli diskutimin sa I perket këtij raporti.

### **III. Shqyrtimi i raportit analitik financiar për vitin 2023**

Kryesuesi e ka prezentu raportin pastaj ka shtuar se e kemi prezent edhe drejtoreshën për buxhet dhe financa znj. Dafina Cacaj. Nëse ka dikush diçka lidhje me raportin e hapim diskutimin.

#### **Blinera Lokaj**

Raporti financiar ngërthen në vete të njëjta dukuri negative sikurse raportet paraprake. Përkundër rekomandimeve të thëna nga auditori i jashtëm dhe kërkesave e çështjeve të ngritura nga ana e opozitës. Më së miri gjendjen financiare dhe shpërndarjen e buxhetit për një periudhë të caktuar kohore. Të gjeturat e buxhetit tregojnë që shpenzimet zyrtare është plot 66.000 euro, që nëse e përpjestojmë për ditë pune i bie që gjatë vitit 2023 për secilën ditë, ju keni shpenzuar nga 264 euro në ditë vetëm për dreka. Për të ardhur keq, pasi që këto mjete kanë mujt me u shpërnda për nevoja të qytetarëve. Po ashtu shpenzimi I buxhetit vjen edhe nga pagesa. Përmes vendimeve gjyqësore të cilat vijnë jo gjithmonë vetëm nga kontrata kolektive, por edhe nga operatorët ekonomik siç është limi\* Vizion, Lika Trade. E pastaj ka edhe emra të përveçëm. Drejtoria për shërbime publike, çka nënkupton përshkrimi I investimeve në vijim. 2 herë është investime në vijim dhe është shumë i paqartë. Po ashtu tek drejtoria për buxhet dhe financa. Çfarë shërbimi ka kryer PRO ACC group, e cila buxhetit të komunës i ka kushtuar plot 27.500 euro? Këto ishin vetëm disa nga të gjeturat e këtij raporti. Ne si grup bëjmë thirrje ekzekutivit komunal që ta ruajë buxhetin dhe të mos e shfrytëzojë pa kontroll.

#### **Drejtoresha per Buxhet dhe Financa, znj.Dafina Cacaj**

Falënderit për pyetjet, dashta me tu pergjigj pyetje që mu drejtove të dreka zyrtare është enorme. Ok, është mendim i yti. Po janë shpenzimet që nuk janë vetëm dreka zyrtare, kanë të bajnë edhe me furnizimin komplet që kemi aktiviteti nuk do me thonë që si ishte përshkrimi drek zyrtare që na jemi duke shku me hongër dikun diçka. Po jan çdo aktivitet që ka të bëj me komunën që është i organizum edhe osht bo shpenzim ne emer te drekave zyrtare. Dhe investimet, investimet ne vijim dmth çdo kontrate që është në vazhdimësi trivjeçare është duke u investuar ajo përshkrimin ose kodin ekonomik e ka investime ne vijim. Ndërsa kompania PRO ACC Group. Është kompani që e ka fitu ni tender për vlerësimin e pronave për vlerësim monetar të pronave komunale dhe të objekteve. Pjesa e 1-rë, ku ne pagese 27,000 euro tash e kam edhe pjesën tjetër është përmblyllë si projektit po duhet me bo pagesën ket vit unë emrat nuk jav kom ngjit, qeshtu qysh I kan pas jav qes paret. Shërbimi që ka kryer vlerësimin monetar pronave ka bo edhe të objekteve komunale që veç e kemi raportin po. Hala nuk e kemi implementuar nëse vlerësoni me jav sjell muj me jav sjell edhe pse asht shume voluminoz.

#### **Orges Tafilaj**

Falënderit kryesues përshëndetje për të gjithë. Prej fillimit të ktij mandati e kemi dëgju drejtoreshën duke thënë që po mundohet me u përmirësu çdo ditë. Kështu që fillimisht po fillojme me i lavdat, mirë që na keni sjellë raporte përmbledhëse për zëra caktum. Megjithatë, unë besoj që do të ishte e dobishme te hynin edhe zera tjerë financiar, një prej tyre do të thoja, unë do ishte e rëndësishme që pasqyrohen llogaritë e pagueshme, për shkak se edhe po ta studiojmë detajisht këtë raport, shohim që ne po bëjmë pagesat gjithmonë këtë vit për vitin paraprak financiar, një numër të madh tyre dhe njëkohësisht po ta dinim për shembull, a kemi pagu

faturat e papaguara, derivateve, fatura të papaguara, dreka zyrtare ndaj operatorëve të ndryshëm ekonomik do e dinim ose do kishim një pasqyrë ma të qarte edhe për gjendjen e komunës, duke e pasqyruar me buxhetin që e kemi. Te pjesa e dreka zyrtare janë 66.000 mbas përmbledhjes, pa përfshin 23.000 që ishin për ushqim dhe pije karburante për vetura, 153.000 rreth 153.000 pa përfshirë 111.000 naftë për ngrohje dhe 46 mijë për derivate për gjeneratorë dhe ajo që është shqetësuese dhe që po diskutojmë çdo herë kur po diskutojmë raporte të tilla jonë janë pjesa e mjeteve që merret përmes vendimeve gjyqësore dhe atyre përmbartimore. Për pjesën e vendimeve gjyqësore pashë te pasqyruar në raportin përmbledhës, por jo atë pjesën e atyre përmbartimore, sepse ishte vetëm një pjesë prej 137.000. Ndërkohë, vlera e tërë i afrohet afër 2 milionëve. Dhe n'këtë pjesë e rreth 500.000 euro merren vetëm nga operatori Lika Trade, afër 500 euro dhe e kemi diskutu prap që njëjtën kohë dhe higjiena ka marrë mjetet financiare përmes përmbartimeve. Besoj që duhet të ketë diskutime nëse jo me operatorët ekonomik, të paktën me kompaninë që ne e menaxhojmë si asamble edhe diskutojmë që mos të na dërgojnë te përmbartuesi kompania Higjiena. Pjesa tjetër që lind si pyetje është, çka është përfshirë në mirëmbajtje rutinore? Kemi mirëmbajtje të automjeteve. Ndërtesa e shkollës apo objekte shëndetësore, teknologjisë, mobiljeve. Pajisjeve të ndryshme dhe pastaj kemi edhe një vajtje rutinore që vlera në krahasim me vitin paraparak është rreth 110.000 më shumë. Nëse mundesh drejtoreshë me na u pergjigj çka përfshihet në mirembajtje rutinore.

### **Drejtoresha per Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj**

Raportin financiar nëse dëshironi me te detajun Une mund te jau dergoj, aty jane te parapame edhe obligime të papaguara. Gjithçka është e inkorporume ne ta, na obligim nuk e kemi me sjell ne asamble, obligim e kam me publiku ne webfaqe. Mirëpo nëse ju e vlerësoni çdo vit kurdo që e përgatiti javë sjell, edhe aty keni taman ne detaje që mos të bëjnë 2 herë, 1 herë për juve ni raport, njëherë për ministrinë, nëse e vlerësoni në muajin shkurt ju sjell në asamble raportin financiar pasqyrat financiare, pasi veç i kom dorëzu edhe nese marr komente, atëherë deri me 20 shkurt ke mundësi me bo Ndryshimet në shkurt që me ardhe te ju me vlerësu edhe ju me diskutu nëse keni diçka me shtu. Edhe obligimet tjera ose te zërat unë nuk muj me ditë saktë çka kem me pagu, na kërkohet të hyjnë si mirëmbajtje rutinore. Mirëpo është kod i përgjithshëm sikur që është mirëmbajtja e ndërtesave, mirëmbajtjen e veturave ose të gjitha mirëmbajtje tjera që kanë një herë si kod pune me vazhdu me mirëmbajtje rutinore. Mirëmbajtje e ndërtesave është e njëjta e njëjta gjë. Nën 3 vendimet gjyqësore ose operatorët. E ata kanë pritur afatin kohor të pagesave. Momentin kur nuk janë paguar obligimet ata kanë shkuar me procedura tjera për realizimin e të drejtës së tyre.

### **Mon Selmanaj**

Të nderuar kolegë tek ky raport vërejmë një tendencë të përmirësimit krahasuar me raportet paraprake, sepse na janë prezantuar të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara për vitet 2022 dhe 2023 dhe krahasimi i tyre. Në fakt në faqen 3 të raportit na mungon planifikimit të hyra për vitin 2022. Përderisa kemi këtë mungesë, nuk mund të themi se kemi 1 krahasim të saktë të realizimit e as përqindjeve të realizimit të të hyrave. Risi tjetër e këtij raporti është se ne na ofruar të gjitha pagesat në vendimet gjyqësore përmbartimore për vitin kalendarik 2023, në mënyrë unike në faqen e fundit ti raporti çka na e ka lehtësuar punën dukshëm ne përpunimin e tyre. Përveç këtyre 2 përpjekje për të përmirësuar pasurimin e tij, brendësi te ky raport nuk shohim ndonjë ndryshim krahasuar me raportet paraprake. Ky raport është tepër shpenzues ose shpenzime të pakontrolluara te të gjitha kategoritë ose programet buxhetore si, Subvencionet, karburantet, drekat zyrtare, kontratat për shërbime të veçanta, shërbimet intelektuale, udhëtimet zyrtare, kredit kartela, vendimet gjyqësore etj. Për të ilustruar këto që po i them, po i marr disa fakte të gjetura në raport e që për mua janë të papranueshme dhe shqetësuese për këto shpenzime buxhetore për këtë periudhë kohe. Vendimet gjyqësore përmbartimore 88. Në shumën prej 2.071.323 euro. Unë ju kam drejtuar zotit kryetar po tash ju drejtoni ju

drejtoresh, se a mund të na shpjegosh pse janë të gjitha këtu vendimet gjyqësore përmbartimore? Mbi 2 milion është dashtë me u pagu me përmbartues ku ne si komunë i kemi dëmtuar bizneset, duke mos ua paguan mjetet në këtë periudhë inflacioni të lartë. Duke i detyruar ata që me procedura gjyqësore ti marrim mjetet e tyre. Beso është shumë shuma apo borxhet e mbetura për vitin 2023 që do të barten në vitin 2024. Pastaj karburantet i kemi në shumën prej 151.044 €. Dreka zyrtare, unë e kom ni shifër tjetër 73.864 euro. Udhëtimet zyrtare dhe medijtje nga medijtjet nga zyra e kryetarit 10.164. Une, nuk e di që Kryetari, ne të gjithë këto udhëtime zyrtare asnjëherë nuk na ka dhënë 1 informacion për punën dhe angazhimet e tij në këto udhëtime zyrtare. Dhe cili ka qenë puna për benefitet e komunës nga nga këto udhëtime, pra meqenëse këtu janë shpenzimet me kredit kartelë 2.426 euro. Zyra e kuvendit karburante 3.887 euro per siç e dini ju koleg nderum Kuvendi nuk posedon makinë paktën zyrtarisht jo. Kur jemi te zyra e kuvendit, atëherë zoti kryesues i kuvendit. Përveç drekave zyrtare që normal pije këto sende të tjera që i duhen kuvendi të gjitha. Me kontrata të veçanta ose të paguhet me kontrata të veçanta nga zyra e kuvendit. Mendoj unë nuk janë të arsyeshme këto. Dhe kisha pas dëshirë që ju të ndikoni që herave tjera në raporte tjera të mos vij në këtë formë, siç janë për zyrën e kuvendit, sepse janë të papranueshme. Janë shumë. Të nderuar kolegë. Unë jam i vetëdijshëm se 1 institucion edhe ma i vogli, qoftë ai nuk mund të funksionojë pa mjete buxhetore. Mirëpo shpenzimi i parashë publike duhet të jetë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, jo shpenzime të pakontrolluara jashtë planifikimeve buxhetore. Ndaj ky raport dëshmon qartë deri në detaje keqmenaxhimin dhe keq shpenzimin e parashë publike.

### **Dafina Cacaj**

Te kriteret kryesore me rëndësi është kualifikimi ose raporti i auditorit Tjetra ka të bëjë me shpenzimin e buxhetit. Unë qata tparën hala skam mujt mi ra në fije qysh me përmirësu, buxhetin bile pe shpenzoj mbi 90 përqind bile qeta mos ma permeni. Se ku ka mjete tjera edhe nëse janë kontrata ose nuk janë të asaj drejtorie une i shpenzoj me faturë. Te kreditkartela kryetarit e 2.400€, krejt vitin 3.000 euro minus mund të merr, ose nëse ka udhëtime zyrtare me i shpenzu domethonë. Unë besoj se është njëri ndër kryetarët që mas paki bën shpenzime zyrtare kudo që shkon. Edhe është hera e 1-rë, viti i 1-rë që e ke zbuluar që mundem me bo tjerët e kanë prej pasluftes. Dhe karburantet shpenzimet për udhëtimet që ai ka për faturat ose për udhëtimet shiko kuvendi ose zyrat. Edhe nëse nuk ka vetura zyrtare na karburantin javë qesim në vetura private për me mujt me kry ni shërbim ose ni punë zyrtare në Prishtinë. E vendimet gjyqësore përmbartimore pjesa më e madhe janë për shujta. Besoj e keni parë prej profesorave në arsim, pjesa tjetër janë prej kategorive tjera që nuk e kanë pritur afatin e pagesës se ka kaluar afati pagesës dhe na kanë detyruar që me shku në përmbartim. Mirëpo më shumë se 1 milionë janë që kanë të bëjnë me shujta.

### **Hyri Dobrunaj**

Ne këto 2 fletë e fundit që janë pagesat me vendime gjyqësore dhe përmbartues, Për periudhën janar dhjetor 2023 figurojnë gjithsej 82 kolona. Shuma totale e paraqitur nga kryetari dhe drejtoresha këtë kolonë është 1.885.976 euro. Fillimisht mendova edhe unë si Moni sa mirë na e paskan bërë punën ma t'lehtë. Por duke e ditë se si funksiononi, si funksionon edhe si maskoni abuzime që i bëni me paratë e taksapaguesve. Isha e bindur që duhet shikuar secilën drejtori veç e veç. Do të thotë nuk i kemi të te 2 kolona ose thënë ndryshe. Këta te dyja gjyqësore, por i kemi 100 lëndë gjyqësore. Vendime me përmbartim. Ku janë edhe 12 pagesa tjera që nuk figurojnë këto faqe. Ju lutem shihni faqen e fundit tek raporti financiar. Drejtoria për shërbime publike dhe kolonat e pa paraqitura, shuma për këto kolona është 104 dhe 1.820. Të gjitha së bashku, atëherë i kemi me përmbartim 2.027.796 euro. Plus 2 kolona tek drejtoratit për shëndetësi me numër rendor 352353 me shumën 85.000 tjera të paraqitura në raportin e bien gjithsejt m 2.112.796 euro. Totali prej këtyre mjeteve 904 3.880 janë paguar nga mallra dhe shërbime, ndërsa nga projektet kapitale janë paguar 1.168.915. Nuk ka rëndësi për çka janë pagu mjetet. A paguhet për shujta apo paguhet për operatorë të ndryshëm. Rëndësi ka



që keni keq planifikim. Që do të thotë se komuna është dashur ti ketë investimet kapitale dikund rreth 4 milionë dhe ka vetëm 2.000.612, Ndonjëherë dhe mund të ndodh që ndonjë projekt të jetë vazhdimësi e një projekti paraprak i mbetur pa paguar për ndonjë arsye ose për një tjetër, por nuk guxon të ndodhë gjykata ti ketë 100 landë nga 1 komunë. Kjo i bie se keni 8,35 landë në muajë, për 12 muaj të vitit. Paramendojeni nga kapitalet i kemi pagu me përmbarues për dreka e darka. Pse nuk arsyetohet? Keni paguar nga kapitalet për naftë, për vetura që nuk arsyetohet mobilje dhe autosallone. S'po hyj në projektin nëse keni bërë gjysmën e re dhe mbesin, mirëpo këto janë kategori që nuk duhet t'ju ndodhë për këto kategori më i madh i kapitaleve. Kjo është abuzim. Kjo me të vërtetë është e pafalshme.

Kjo është arsyeja pse komuna e Deçanit nuk i ofron asnjë shërbim normal qytetarëve të saj. Këtë e shpjegon ma së miri fakti nese shiqoni faqen 10 te kodi 1 4 0 3 2 mirëmbajtje auto rrugë lokale 0 euro për 2 vitet e fundit kjo është mjerim edhe tek mallra shërbime sipas programeve me kod 1 4 4 1 10 dhe i kemi mbi 92.950 euro pagesa. Për ndëshkime për vendimet gjyqësore, kjo do të thotë se nga mallra shërbime janë marrë gjithsej 1 milion. 0 36. E kom ni pyetje për drejtoreshën këtu, ket fletën e 1-rë tek kolona tek ky kodi 1 4 0 6 0 o shuma 120.000. Ndiqe 35.000 në vitin 2023. Çka nënkupton kjo? Edhe plus. Mirëmbajtja rutinore, çka çuni mirëmbajtja rutinore se nuk është pak 130.000 euro.

### **Dafina Cacaj**

Na ka ardh hesapi mu mar me kolona domethonë un shumë mirë I kom punt edhe mum kqyr sa kolona I kam mungu prej cilit rresht. Dhe përgjigjja, mirëmbajtja rutinore service pyetje mrriva me me bo Jon, mirëmbajtja e rrugëve. Mirëmbajtja, ndërtesa, mirëmbajtja e makinave të gjitha hyn në mirëmbajtje. Nuk ka lidhje cili kod në audicionin e kemi ma të përshtatshëm për me bo rrugë. Mirëmbajtja e rrugëve nuk është kapitale.

### **Faton Selmanaj**

Faleminderit kryesues, pyetja ime është lidhur me vlerësimin pronave Kompania PRO ACC grup. Cili është qëllimi i atij vlersimi?

### **Dafina Cacaj**

Qëllimi i vlerësimit monetary të pronave , prona komunale është se ma herët nuk e kemi pasur një vlerësim të pronave. Ndoshta jemi ndër pak komuna që kemi bo sivjet e disa kan fillu, por shumica nuk e kanë bo hala, na jo pse jemi në hapat e 1-ra të tjerëve duke marrë vërejtje prej auditorëve 2 herë, 2 vite më herët rresht dhe e kemi vlerësu qe me ba një kompani private se është ma e sigurt ndoshta, se sa me ba vet me komisione dhe merr shumë kohë. Jam konsultu dhe me auditorët e me tjerë që është më e arsyeshme. Është me bo ni kompani e licensuar për këtë punë dhe Regjistrin e pasurive nuk figurojnë pronat komunale, edhe osht ni vlerësim i objekteve komunale që e kam pas deri tash e për këtë arsye kemi vendosur dhe kemi vlerë monetar edhe të pronave dhe objekteve që ka dalë vlerën 6, 3 milion pasuria e komunës prej pronave dhe objekteve komunale.

### **Sylë Balaj**

Pershendetje per tegjitheve e kisha 1 pyetje rreth raportit financiar, ku janë mbi 150.000 euro te shpenzimit të karburanteve a bon me dit sa vetura i posedon komuna e Deqanit pse janë gjith ato shpenzime.

### **Dafina Cacaj**

Veturat nuk I kam me numer Sa I posedojn institucionet ne pergjithesi, po karburantin ne mungesë të veturave zyrtare ja qesim në një veturë të zyrtarit që mundet me kry një shërbim deri në Prishtinë. Nuk mundemi mu

blloku punët pse nuk kemi ni veturë zyrtare o fjala unë drejtoris teme se vetura zyrtare janë edhe zjarrfiksat që kanë nashta shpenzime ma tmdhaja ose QKMF-ja me autoambulancë dhe këto te tjerat. Nuk e di sa I kem se nuk e di numrin e saktë.

### **Vatan Istrefaj**

Kryesues. Atëherë po rreth raportit financiar për të mos i përsëritur ato që i thanë kolegët në radhë. Po po shohim që është 1 avaz i njëjti përdorimit, por keqmenaxhimit financiar shihet se ka rregullisht përmbarues. Dreka darka mbi 8.000 euro, por përse drejtoreshë nuk e merrni asnjëherë vërejtje për pronën? Po shihni pronën komunale si pronë private këtu apo si institucion komunal. Këtu është vërejtja. Pse ne shohim ne çdo raport ku kemi domethënë dreka zyrtare top luks non stop edhe mos pahiri këto të dreka zyrtare është shfrytëzuar dhe për takime partiake.

### **Dafina Cacaj**

Nuk mundet shpenzimet per dreke me pagu diçka tjetër. Unë çkado që kemi shpenzu dhe kemi pagu dhe gjithçka është arsyetu me faturë . Ne fakt për çdo shpenzim ne japin llogari, unë jap edhe dikujt tjetër, këtu japim sqarime për çka keni ba ju pyetje normale jo me tendecë.

### **Miftar Ahmetxhekaj**

Atehere Faleminderit, ndoshta e kemi thënë edhe raste të tjera, e para, jan 3 dokumente bazike qe realisht edhe ju si pushtet ekzekutiv duhet ti kushtoni rendesi . Edhe duhet ti merrni pak sugjerime. Ndoshta pak ma me sportivitet. E 2-ta po flasim për ni procedurë I cili shkel zotin taksat që. Çka është? Raporti i 3-të nëse sgaboj jeni duke e trajtuar është përgjigja ose. E përfundojmë. Përmirësuar une nuk e marr të drejtën shumë. E kur ju nënshkruani kontrata për shërbime. Persona fizik, njëjtë të njëjtët persona. Krijoni marrëdhënie. E ju mos zgjidhnin rrugë tjera për postimin. E.

### **Hajdar Sutaj**

Falemnderit, pasi që nuk k ate lajmeruar tjerë për fjalë e mbylli si temë.

#### **IV. Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës së kuvendit për vitin 2024.**

Kryesuesi e prezentoj piken pastaj kërkoj prej grupit AAK a ka dikush diçka më thonë. Ju prej grupit LDK-së. Ai ka thënë per materialin të cilën e keni e keni përpara, e kemi edhe ni pikë të cilën e kemi shtu në muajin Qershor- Raporti i auditorit të jashtëm për NPL “Higjiëna”, pastaj e hapi debatin rreth kësaj teme.

### **Hyrije Dobrunaj**

Plani i punës së kuvendit unë besoj që duhet me shtu, sepse është 1 punë që e dimë që duhet të mendohet në komunë gjatë vitit, raportin analitik financiar tremujor. Përfshijnë, ai duhet me qenë besoj, duhet me qenë prill qershor shtator. Plus edhe për përgatitjen e buxhetit, për buxhetin edhe Korniza e 1-rë.

### **Hajdar Sutaj**

Kështu ne, për shembull ne kete periudhe, kemi raportin shqyrtimi i raportit financiar periudhën janar 31.03.2004. Po ashtu e kemi në Nëntor Shqyrtimi i raportit nëntë mujor financiar.

## **Mon Selmonaj**

Faleminderit. Për miratimin e këtij plani të punës. Ne na duhet që për janar pikën 3 dhe 4 te parapame, Me hartimin e planit që keni bërë ju këto dyja duhet të hiqen nga ky plan dhe pastaj të miratohet si tërsi nëse të gjithë pajtohen. Unë propozoj që këto 2 pika të largohen ng këtu sepse nuk mund të miratohen. Ose ky plan nuk mund të miratohet. Nëse janë këto 2 pika, Marrja vendimit paraprak për dhënien e pronave në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 vite, dhe Formimi i komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme. Nuk mund të miratohet ky plan me këto 2 pika Brenda, prandaj unë kërkoj që këto dy pika të hjeken dhe Njerëzit i japim votën për miratimit të tij plani, kështu që faleminderit.

## **Albesa Cacaj**

Thotë se kam propozim për pika të rendit të ditës, e propozoi. Raporti i performancës komunale, sepse vitin e kaluar nuk ka qenë , pastaj konsideroj tejet e rëndësishme raportin për barazi gjinore. Edhe ky plan i punës parashihet që së paku 2 herë kryetari i komitetit vjen dhe na jep raport për të arriturat, poashtu edhe objektivat e planit për barazi gjinore. Gjithashtu konsideroj të rëndësishme, edhe pse s'ka qenë praktikë deri më tani, por është edhe ky obligim ligjor i cituar që plani I aktiviteteve të komitetit për komunitete së paku 2 herë në vit, komiteti për komunitete të raportoje në kuvendin e komunës për punën, objektivat dhe aktivitetet. Kjo ishte rekomandim.

## **Miftar Ahmetxhekaj**

Po ndaj tendencë definitivisht problematike është pjesa e janarit. Na i kemi 3 ose 4 pika, të cilat realisht nëse votojmë. Diçka që nëse realizëm që. Është mirë kjo. Edhe unë e kam ni parë problemi, edhe pse ne kalum si i tillë emërtimi raporti i kryesorit që ky premtim. Nëse lexojmë ditën e raportit realisht të raportit 20. 1 ose me ndryshu e raportit mund të jetë teknik. Po realisht raportet janë për ekzekutive. Raportit nuk është enkas i kryer.

## **Albesa Cacaj**

Diskutohet por nuk votohet, është obligim ligjor brenda vitit kalendarik, tashme me propozim.

## **Hajdar Sutaj**

Të falemnderit shumë diçka tjetër apo dikush. Kështu ish as propozimet të cilat u japën nga ne mos te propozimin e tanishëm. Rol, por shqyrtimi i raportit të jashtëm të auditorit për NPL higjiena në muajin qershor, ku shpër. A ka kundër. A ka pse ne? Konstatoj që e kemi shti si propozim që ti largojë këto 2 pika, të cilat i propozoi Mon Selmonaj, gjegjësisht pika 3 dhe 4, të cilat janë propozim Konstatoj që e kemi futur propozim. I. Që të futet të propozim komiteti raport i komitetit komunitetin muajin korrik, kus është për. Edhe dhjetor ku ka konkurrencë edhe dhjetor. Falemnderit raporti për barazi gjinore qershor. Kush për. Edhe raporti për performancë komunale. Atëherë ne me propozimet të cilat kanë qenë edhe me propozim, ndryshimet të cilat i bobë sot e qes në votim Planin e punës së kuvendit për vitin 2024, Konstatoj që në mënyrë unanime kuvendi ka miratuar planin e punës për vitin 2024.

## **V.Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe mbledhjeve të KPF-së**

Kryesuesi e prezentoj kete pike pastaj hapi diskutimin rreth saj.

## Hyrije Dobrunaj

Prapë qëndroj te propozimi im ku kam kërku qe mbledhjet e kuvendit të mbahen të premtën e fundit të muajit. Vetëm në rastet kur ka ndonjë pjesë ose diçka tjetër për arsye se edhe ne jemi të koncentru në mendje që të premtën e fundit ka mu majt mbledhja e kuvendit.

## Miftar Ahmetxhekaj

Termi mbledhje publike, kështu që është ndoshta mirë me konë janë takime Mbledhjet e kuvendit, ndërsa çdo gjë tjetër është takim publik se s'ka mbledhje. Dhe kush e zbaton unë këtu pak kam dilemë. Unë mendoj se së pari do të jetë kuvendi për shkak se ne jemi sponsorizuar, Mund të jetë kryetari i 2-ti, po parësore duhet të jetë kryesuesi eventualisht, Kuvendi e monitoron, kuvendi është ai i cili e zbaton.

## Hajdar Sutaj

Koleg i kemi 2 propozime realisht 3 propozime të cilën e kemi sjellë në propozimin që edhe kolegja Hyri Dobrunaj dha, dhe propozimet që dha zoti Miftar Ahmetxhekaj. Sa i përket propozimit për të premtën e fundit, personalisht po foli, mendoj që të jetë fundi i muajit. Nuk na obligon vetëm për një ditë të caktuar, sepse kur e obligoi atë ne patjetër duhet me zbatu. Sa i përket propozimit të kolegut Miftarit, po, mundemi për me ba këtë ndryshim.

## Florim Mataj

Të propozimi qe tha kolegët për takimet publike. I thirr kuvendi na e kemi edhe në statut që kemi të drejtën në takime publike.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, atëherë e qes ne votim fillimisht propozimin për mbajtjen e mbledhjes në të premtën e fundit të muajit, propozim i cili nuk kalon, pastaj e qiti ne votim propozimin qe mbledhja te mbahet ne fund te muajit, me 14 vota miratohet. Ne e kemi lënë që fundi i muajit jetë mbledhjet rregullta të kuvendit. Jemi të propozimi i zotit Miftar Ahmetxhekaj që të ndërrohet terminologjia, Jo mbledhje por takim të jetë, me të cilin propozim pajtohen.

Miratohet vendimi për mbajtjen e mbledhjeve te rregullta dhe mbledhjeve publike të kuvendit si dhe mbledhjeve të KPF-së për vitin 2024, me të cilin vendoset që mbledhjet e kuvendit të mbahen në fund të çdo muaji, si dhe te neni nr.3 duhet të bëhet ndryshimi te terminologjia në vend të mbledhje publike duhet të jetë takime publike të Kuvendit, te neni 7, zbatimin e vendimit e bënë, së pari- kryesuesi dhe kuvendi, pastaj Kryetari I Komunës, vendimi merret me 2 vota abstenim, 24 për.

## **VI.pika 6, Marrja e vendimit për ndarjen e parcelave për ndërtimin e 3 çerdhe për fëmijë në fshatin Gramaqel, fshatin Isniq dhe në fshatin Strelle i Epërm**

Kryesuesi- e prezentoj piken pastaj e përshëndeti drejtorin e arsimit, i cili është këtu Besnik Hulaj, e aki diçka me prezantu tash apo vetëm më i referoheni materiali të cilin keni marrë.

### **Arjan Dobraj**

Falemnderit kryesues. Si grup e kemi mirëpritur këtë aksion. Është 1 ide shumë e mirë dhe 1 plan shumë i mirë. Edhe natyrisht që do të më përkrahë fuqishëm me çdo lloj kompetence secili prej neve, sepse është 1 projekt shumë i mirëseardhur. Nuk kemi diçka tjetër me shut, falemnderit.

### **Hajdar Sutaj**

Falemnderit shumë prej LDK Vatan Istrefaj.

### **Vatan Istrefaj**

Sa i përket kësaj pike, pra jemi shumë në rregull. Projekt i qëllueshëm. Megjithatë unë kam 1 pyetje te Fshati Strelle i Eperm, pra drejtori i shkollës ka mbajtur 1 takim me këshillin e prindërve, këshillin e shkollës dhe mësa kam informatë janë koordinuar që të jetë aty tek fusha sportive. A ka mundësi drejtori me na shpjegue, ku do të jetë saktë dhe nëse keni bërë ndërrimin e lokacionit për afër shkollës vjetër me na treguar, pra edhe për kapacitetin sa do të jenë. A do të jetë me numër afërsisht e fëmijëve që do të jenë ato lokalitete?

### **Drejtori I Arsimit, Besnik Hulaj**

Ka sqaruar për lokacionin ku do të vedoset si dhe takimet që ka pasë me drejtorin e shkollës në fshatin Strelle si dhe kapaciteti për 40 fëmijë që ndërtohet çerdhja.

### **Faton Selmanaj**

Ne si grup e përkrahim këtë kërkesë, por unë po tani pyetje për drejtorin, sa është kapaciteti i gjithë së cilës çerdhe veç e veç. Sa ka kapacitet për akomodim.

### **Besnik Hulaj**

Kapaciteti çerdhe është më e vogël. Për momentin vetëm projekti është sjellur nga Minitaria dhe nuk jemi të informuar sakt për kapacitetin.

### **Mon Selmonaj**

Drejtor përshëndetje. Nëse citimin tuaj në pikën 3 thuhet, mendojmë që do të kemi nevojë për këto çerdhe të reja në komunën tonë. Njëkohësisht janë bërë analiza të tjera. Duke mos përjashtuar vështirësi të tjera organizative që dalin në vazhdim për funksionimin e çerdheve që janë në kompetencë nese e komunës dhe. Atë rëndësinë bo analiza të thukta të mirëfillta atëhere. Cilat janë këto vështirësi që do të na paraqiten organizative? Sepse ne nuk mund të ndërtojmë çerdhe nëse kemi paraprakisht jemi njoftuar për vështirësitë organizative, nuk po thotë. Vështirësitë që na dalin po organizative , domethonë që komuna ka vështirësi në funksionimin apo menaxhimin e tyre e tyre. Qerdheve mund të na shpjegosh çka keni desh me thone. Me këtë, duke mos përjashtuar vështirësi të tjera organizative.

## Besnik Hulaj

Për pyetjen fillimisht nuk jam vështirësi . Kjo është 1 ndër vështirësitë e 2-ta është prej këtu duke marrë. Pas plotësimit, duke organizuar edhe fjala, ka qenë për vështirësitë, por deri te rregullimi kompeticioni.

## Miftar Ahmetxhekaj

Por a përgëzoj për projekte. Është prej kërkesave, por personalisht shikon drejt kuvendit. Infrastruktura të tillë, siç janë. Por unë i kam 2, 3 dilema. Proceduralisht diku kanë shkulur për ato projekte apo projektet ekzistuese. Cilën letër kush i ka hartuar këtë projekt edhe aq doshme që material në të na vijnë për shkak se për ta provuar. Shihni si kuvend të japin mbështetje, përdoreni përcjell, thoshte paraprakisht ta dimë, fillon shtrirja doza e. S'është problemi shëndoshta tis nisni sikoni parcelës që është mjaftueshëm. Është problemi të shohi stres. Unë jam munduar dhe jo për ta dashur ta përcjellë. Nëse ju apo 1 afër shkollës etj. Për dijeninë tuaj ajo është objekt i trashëgimisë që ju thashë ju. Ushtroni vështirësi që nëse është më afër se 50 metra, ju duhet të keni ministria e kulturës ta merrni vesh. A ka projekt nëse e ka bo komuna pse sot s'osht? Sepse keni sjellë në kuvend ta shohim shtrirjen, bazat. Prerja e objekteve në parcela kaq. Përndryshe.

## Besnik Hulaj

Pyetje. Planet. I. Poshte bazë dhe njoftimin e. Ministria i ka gjitha zonat përmes 1 që është i formatit për mësuesit e. Bota e filmit tonë. Po e kom. E. E gjitha statistikën i cakton ministria na vetmit obligum e. E merr edhe komplet me projektin se është edhe e. Sepse pali e mundur. Procedura e leja e ndërtimit pa leje.

## Miftar Ahmetxhekaj

Dritarja kështu shkoj unë e përfaqësoj tash pse po e them këtë. Unë përfaqësoj rastet e tjera dhe nismën tjetër nëse. Une votoj për vendosjen e shkollës së stresit në 1 parcelë, e për të cilën unë për momentin nuk po di ku vendoset dhe eventualisht ajo vendosi bëhet më afër se sot 5 metra afër shkollës së vjetër u nevojit shkeljet këtu e kom.

## Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtorja keni për ni koment shtesë. Ju e Besnik Hulaj e ka fjalën drejtor veç.

## Besnik Hulaj

Me e. Si përgjigje e shkolla por. Edhe jemi shumë. Gjenerali se ajo është ndryshe. 2 be ministri dhe disa zyrtarëve që merren me e kulturore. Kemi pas kontakte dhe. E në të ardhmen. Gjithçka është e mundshme. Afër mundem sepse mungese hapësira publike. Gjithçka i është aty mor edhe edhe përgjigje pyetjeve, por edhe i. Se s'po ti rrezikohet 1 hapje trup. Gjithçka i kemi diskutuar aq sa nuk shkon pa diskutu sepse nuk u mor 1 vendim. Ju largoni organet legjislative dhe normalen i përgjegjë. Jemi për me mbrojtë sysh.

## Hyri Dobrunaj

Edhe unë gjithashtu ju përgëzoj për ndarjen e parcelave për punën që po e mbani mend ato parcela për çerdhet e fëmijëve ka qenë kërkes. E kahershme secilit anëtar të asamblesë besoj unë sepse ka qenë nevojë. Kjo është 1 lehtësim, pranon ate ja cila do i me punu edhe e mirëpresin keni. Dokumentacioni unë besoj që në suazat lici kemi shquar dhe mendo parcellat me pregatit dokumentacion. Nuk dyshoj aty që nuk e bëni mirë punën e kom ni pyetje tjetër komuna e Deçanit para ni kohe ne e ka ndërtu ni çerdhe për fëmijë, mirëpo ne si komunë nuk kemi qenë në gjendje me e menaxhua çerdhe dhe ajo ka kaluar në Në sektorin privat. Sot ne nuk e dimë as ta paguaj qira pra çerdhe a paguhet as paguhet hiç çka merr komunave asaj nuk e kemi asnjë informacion.

Unë e kom pyetjen konkrete këto çerdhe a kan me met publike, a ka me kon publiko private apo kanë keni privatizuese mi sikur edhe ata, por kjo është pyetja dhe dilema ime.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit Hyrije Besnik Hulaj drejtori e ka fjalën.

### **Besnik Hulaj**

E ministri dhe. Cilat kanë qenë publike? Po si kosto shumë. E shpenzimet sepse gjithçka do të jetë e. Njëkohësisht.

### **Hajdar Sutaj**

Faleminderit drejtorit z. Vatan Istrefaj ka nje pyetje.

D

## Vatan Istrefaj

1 burrë që. Super full paguhet përgjithmonë. Drejtori i lirë. Drejtori i lirë me shku kur dushi. Vazhdojmë. I kryesuesit e lypa fjalën rryma e fjalën tungatjeta. Kryesues, kështu që ke bo ni kërkesë rreth llap topa për me pajis kuvendi komunal. Kështu që kjo kërkesë me citove drejtoreshë si ca ketu.

## Hajdar Sutaj

Juve. Apo diçka tjetër. Koleg meqenëse nuk ka tjerët, lajmëron për fjalë. Faleminderit për kontributin ket seanc e shpalli tmbyllur takimin, shihemi mbledhje të radhës.





**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**  
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA E DEÇANIT**  
**MUNICIPALITY OF DEÇAN**  
**OPSTINA DEÇAN**



---

# **PLANI PËR TRASHËGIMINË KULTURORE TË KOMUNËS SË DEÇANIT 2024 - 2029**

## **(DRAFT)**

**Deçan, Shkurt 2024**

## **PËRMBAJTJA:**

<b>1. HYRJE</b>	<b>fq. 3</b>
<b>2. HISTORIKU I DEÇANIT</b>	<b>fq. 4</b>
<b>3. METODOLOGJIA E PUNËS GJATË HARTIMIT TË PLANIT</b>	<b>fq. 6</b>
<b>4. OBJEKTIVAT E PLANIT</b>	<b>fq. 6</b>
<b>5. TRASHËGIMIA KULTURORE NË DEÇAN, (ANALIZA SWOT)</b>	<b>fq. 9</b>
<b>6. TRASHËGIMIA KULTURORE NË KOMUNËN E DEÇANIT</b>	<b>fq. 11</b>
<b>7. LISTA ME OBJEKTET E TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOMUNËN E DEÇANIT, QË JANË NËN MBROJTJE TË PËRKOHSHME NGA MKRS</b>	<b>fq. 12</b>
<b>8. PRIORITETET SIPAS PLANIT</b>	<b>fq. 16</b>
<b>9. MASAT REKOMANDUESE SIPAS PLANIT</b>	<b>fq. 17</b>
<b>10. MIRATIMI, REALIZIMI, ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT</b>	<b>fq. 19</b>
<b>11. NDIKIMI FINANCIAR I PLANIT</b>	<b>fq. 20</b>
<b>12. GJENDJA FIZIKE E OBJEKTEVE KULTURORE NË KOMUNËN E DEÇANIT</b>	<b>fq. 20</b>
<b>13. LISTA E AKTIVITETEVE KULTURORE TRADICIONLE NË FUSHËN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOMUNËN E DEÇANIT</b>	<b>fq. 20</b>
<b>14. REZULTATET E PRITURA TË PLANIT</b>	<b>fq. 21</b>
<b>15. EKIPI I PUNËS GJATË HARTIMIT TË PLANIT</b>	<b>fq. 21</b>

### **1. HYRJE**

Rëndësia e trashëgimisë kulturore si resurs për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor në nivel vendi është e madhe. Komuna e Deçanit me trashëgiminë kulturore që ka dhe me potencialet e shumta të trashëgimisë natyrore ofron kushte dhe mundësi të mëdha zhvillimit të turizmit.

Qëllimet e këtij Plani janë në përputhje të plotë me politikat shtetërore të paraqitura përmes Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturorë 2017-2027, me theks te masat e parapara për arritjen e qasjes së integruar në trashëgimi, përfshirjen e trashëgimisë kulturore në planet zhvillimore (komunale), promovimin, shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore si dhe mbrojtjen e saj.

Objektivat e Planit për Trashëgiminë Kulturorë të Deçanit 2024-2029, qëndrojnë paralel me objektivat e shtyllave tematike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim të vendit dhe planeve të nivelit komunal.

Dhe për qëllim ka të planifikohet identifikimi, ruajtja dhe promovimi i aseteve të trashëgimisë kulturore në komunën e Deçanit, si dhe prezantimin e trashëgimisë kulturore, analizën e gjendjes në fushën e trashëgimisë kulturore, dhe hartimin në një kalendar zyrtar për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe tradicionale në Komunën e Deçanit.



Me planin zhvillimor komunal si dhe me draft-planin e ri në përgatitje të komunës së Deçanit parashihen potencialet e Komunës së Deçanit në sferat e trashëgimisë kulturore, arkitekturore dhe trashëgimisë natyrore si mundësi për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe zhvillimin e turizmit.

Ky plan, tenton që ta ndihmojë Komunën e Deçanit ta ri pozicionojë rolin e kulturës në një pozitë të merituar gjithnjë në saje të pasurive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore që kemi si komunë.

Mbledhja e të dhënave dhe shqyrtimi i gjendjes kanë filluar me dokumentimin e objekteve dhe lokaliteteve të trashëgimisë kulturore që është bërë në nivel komune.

Në detaje, gjatë vitit 2023 janë identifikuar objektet dhe lokalitetet në komunën e Deçanit, duke i analizuar nga aspekti ligjor, i pronësisë, gjendjes fizike, mundësive së qasjes dhe potencialit për zhvillim dhe për bazë u morën të gjitha këto fakte dhe argumente.

Plani për Trashëgiminë Kulturore - ka për bazë të kuptuarit e gjendjen aktuale sot të trashëgimisë kulturore në Deçan si dhe mundësitë për të ruajtur dhe promovuar këto asete kulturore.

### **Gjatë draftimit të këtij Plani, do të konsultohen:**

-Pronarët e objekteve kulturore, si: pronarët e aseteve kulturore, pronarët e lokaleve hoteliere me ushqim tradicional, zejtarëve tradicional dhe persona tjerë me peshë në fushën e të tjera të trashëgimisë kulturore. Punëtorët profesional brenda komunës dhe me gjerë ekspertët e fushës.

-Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile dhe bizneseve, të cilët u konsultuan për analizën e problemeve kryesore të fushës.

Po ashtu, gjatë draftimit të planit u morën parasysh trendët dhe praktikat e mira në Kosovë të një qasje bashkëkohore për trajtim të trashëgimisë kulturore. U shqyrtua plani komunal për zhvillim, gjithashtu, u shqyrtuan projektet dhe iniciativat e tjera lokale apo nga donatorët e huaj për Komunën në mënyrë që të jenë komplet drejt realizimit të qëllimit të përbashkët që është ngritja e ekonomisë lokale dhe mirëqenies krahas pasurive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ka Deçani me rrethinën e vet.

## **2. HISTORIKU I DEÇANIT**

Deçani, si vendbanim është i hershëm, dhe si komunë (fshatrat përreth), ka një të kaluar të lavdishme me plot ngjarje e dëshmi historike dhe ndër të tjerat si dëshmi, sot, kemi objektet e trashëgimisë kulturore dhe historike të Deçanit, që ndahen në: lokalitetet e mundshme arkeologjike (vetëm të evidentuara), objektet fetare, kullat e gurit - Dukagjinit (Deçanit), monumentet kushtuar luftës dhe dëshmorëve të vendit.

Pjesë e rëndësishme e jona është edhe Trashëgimia kulturore – shpirtërore, siç janë: folklori burimor, lojërat tradicionale, zejtaritë tradicionale si dhe ushqimet etj.

Ky Plan është me interes të veçantë për komunën dhe komunitetin në tërësi, sepse kemi të bëjmë me një trashëgimi historiko-monumentale, shpirtërore kulturore të trashëguar ndër shekuj me radhë, nga e kaluara jonë e lavdishme deri në ditët e sotme.

### **Pozita Gjeografike e Deçanit**

Deçani është komunë që gjendet në pjesën Perëndimore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Pejës, Gjakovës, Junikut dhe me Republikën e Shqipërisë. Është buzë rrugës, në mes të Pejës dhe Gjakovës. Deçani kishte një territor prej një sipërfaqeje me 371 km<sup>2</sup>, më 40 fshatra, (deri në vitin 2009, kur Juniku certifikohet si komunë), tash ka 284 km<sup>2</sup>. Me një popullsi rreth 40.000 banorë.

Komuna e Deçanit si zonë etno-gjeografike është pjesë përbërëse e Rrafshit të Dukagjinit, me disa veçori në organizimin e jetës në të kaluarën. Deçani ka pozitë të mirë gjeografike.

Rruga automobilistike nëpër Pejë, Zhleb dhe Rozhajë bën lidhjen më të shkurtër me Detin Adriatik, ndërsa nëpërmjet Gjakovës dhe Prizrenit lidhet me pjesët Jugore të Kosovës dhe me Shqipërinë. Po ashtu ka lidhje automobilistike me Shqipërinë përmes Junikut për në Bajram Curr të Shqipërisë. Si dhe përpjekjet për rrugën e re Deçan – Plavë e cila do të jetë e një rëndësie të veçantë për komunën tonë dhe rajonin në fjalë.

Deçani në regjion shquhet si qendër turistike-rekreative. Bukuritë natyrore të rralla në rajon, këtij mjedisi i japin karakteristika të veçanta në Rrafshin e Dukagjinit dhe më gjerë në Kosovë. Lumëbardhi i Deçanit, ka një gjatësi prej burimit deri në derdhje në Drinin e Bardhë prej 53 km. Deçani është i njohur edhe për pyjet e larta, kullota të shumta, florë dhe faunë të pasur si dhe ajër të freskët dhe të pastër të Alpeve Shqiptare. Në afërsi të ndërtesave të “Pushimores” (tani shfrytëzohen nga ushtarët e KFOR-it) gjendet Gryka e Lumëbardhit të Deçanit. Aty afër është i ndërtuar manastiri i Deçanit. Po aty afër gjendet burimi (Gushavci) i ujit mineral. Këto resurse dhe pasuri tjera natyrore kanë ndikuar që Deçani të bëhet si qendër gravituese e një regjioni të madh që u vendos me dt. 01.01.1960.

Ekonomia e komunës sonë, kryesisht varet nga bujqësia. Klima e mirë dhe uji i pastër i jep Deçanit një përparësi për zhvillimin e turizmit dimëror dhe atij veror. Bjeshkët e Nemuna dhe trashëgimia kulturore janë dy nga atraksione të mëdha (të mundshme për zhvillim) turistike.

### **Deçani si vendbanim i hershëm**

Emërtimi Deçan-i, (desh+ani-i) emër vendi që çon ka kohët e hershme, është emërtim ilir. Prania e kësaj baze daton nga parahistoria, duke vazhduar në kohën antike, mesjetare dhe deri në ditët tona. Emri Deçan ka ruajtur kuptimin e plotë gjatë mileniumeve (Dasi, Dashi, Dasi-ani, Dasiani, Dashiani, Daçiani, Deçani, Deçan). Emërtimi Deçan (ku ndodhet Manastiri), deç-an=ana e deçve (deshve), vendi ku ka shumë desh. Territori i sotëm i Deçanit ishte i banuar nga dardanët qysh në kohërat e lashta (parahistoria). Gjurmët e ndryshme të vendbanimeve të lashta edhe sot e dëshmojnë atë, duke u nisur nga dëshmitë etnografike, kulturore, historike, toponimike, topografike, arkeologjike si dhe dokumentet e ndryshme arkivore.

Deçani në dokumentet e para të shkruara së bashku me disa fshatra përmendët shumë herët, për herë të parë gjendet në kristobulën e Deçanit në vitin 1330.

Për të kaluarën dhe njohjen e strukturës etnike të popullsisë së Deçanit me rrethinë, rëndësinë më të madhe në burime e ka defteri i hollësishëm i Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485. Evlia Çelebiu, vrojtues i terrenit shqiptar e ballkanik në vitet 1660-66.

**Vendbanimet e Komunës së Deçanit janë:** Deçani, Belleja, Belegu, Belleja, Irzniqi, Drenoci, Lloqani, Vokshi, Pobergja, Hulaj, Prejlepi, Isniqi, Strellci i epërm, Strellci i poshtëm, Lëbusha, Carrabregu i ulët, Carrabregu i epërm, Gllogjani, Lluka e poshtëm, Lluka e epërm, Lumbardhi, Kodralia, Duboviku, Shaptej, Gramaçeli, Jasiqi i ri, Rastavica, Baballoqi, Dubrava, Mazniku, Dashinoci, Pozhari, Ratishi i Ulët, Ratishi i epërm, Prapaqani, Papiqi, Pleqe, Prokolluku, Sllupi, Vranoci i Vogël.

### 3. METODOLOGJIA E PUNËS GJATË HARTIMIT TË PLANIT

Institucionet e përfshira në përgatitjen e Planit për Trashëgiminë Kulturore të Deçanit 20234-2028, do të jenë: Komuna e Deçanit, Kryetari i Komunës, nënkryetari i komunës Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport; Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim; Drejtoria për Arsim; Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit; Drejtoria për Buxhet dhe Financa; Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural).

Krejt këtë proces e ka udhëhequr Komisioni për identifikimin, ruajtjen, mbrojtjen, promovimin dhe shfrytëzimin e Trashëgimisë kulturore, komision i themeluar nga Asambleja Komunale e Deçanit. Në këtë mënyrë është vepruar që të plotësohen objektivat e përgjithshme dhe qëllimi i programit është shfrytëzuar metodologjia e punës gjithëpërfshirëse, që në vete përfshin grupeve të ndryshme të interesit njohës të trashëgimisë kulturore, organizata, shoqëri civile e zyrtarë komunal të kyçur në procesin e identifikimit, dokumentimit, ruajtjes, promovimit dhe të shfrytëzimit të trashëgimisë kulturore në Komunën e Deçanit.

Hartimi dhe aprovimi i këtij plani për trashëgimi kulturore do të trasojë më lehtë rrugën për përkujdesjen, mbrojtjen, promovimin, investimin dhe zhvillimin e projekteve të mbështetura nga Komuna e Deçanit në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, si dhe do të aktivizoj një numër projektesh nga ana e Organizatave të Shoqërisë Civile të cilat do të kenë ndikim në ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore duke përfshirë mundësitë e materializimit dhe përfitimit ekonomik nga trashëgimia kulturore.

Plani u hartua në këto faza:

- Mbledhja e të dhënave, analiza e gjendjes;
- Identifikimi i problemeve dhe analizimi i mundësive-formave për zgjidhjen e tyre;
- Draftimi i Planit dhe strategjia e Veprimit;
- Konsultimet komunale dhe publike.

### 4. OBJEKTIVAT E PLANIT

Objektivat e këtij Planit, kryesisht janë të bazuara në SKTK 2017-2027) (MKRS), por gjithsesi i janë përshtatur kushteve dhe specifikave që ka Deçani si komunë. Objektivat i ndajmë në objektivat praktikë dhe objektivat e përgjithshme.

*Objektivat praktike të planit, janë:*

1. *Evidentimi i objekteve dhe lokaliteteve me rëndësi kulturore dhe historike,*
2. *Përpilimi i Listave me objekte që kanë prioritet për intervenim dhe restaurim,*
3. *Përgatitja e projekteve për restaurim të objekteve me prioritet,*
4. *Përgatitja e projekteve dhe aplikacioneve për Aplikim (donacione) për intervenim restaurim nga MKRS, OJQ ndërkombëtare dhe të tjerët,*
5. *Planifikimi në kalendar, me prioritet i aktiviteteve kulturore tradicionale,*
6. *Planifikimi i Trajnimeve të ndryshme për informim dhe vetëdijësim të pronarëve të aseteve për mundësitë që mund të përfitojnë në të ardhmen, përmes projekteve të financuara nga grantet e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare.*

7. *Të përmirësojë gjendjen e të gjitha monumenteve kulturore dhe natyrore në komunën tonë, duke vazhduar të bëhet restaurimi, mirëmbajtja e të gjitha objekteve të lashta historike dhe monumenteve të reja si shtëpitë (kullat) muze, komplekset memorialë etj. Të ruhen të promovohen dhe të shfrytëzohen në të mirën e komunitetit.*
8. *Deçani të bëhet destinacion turistik në vend dhe rajon, në saje të potencialit kulturor dhe natyror.*

**Objektivi i përgjithshëm** i planit është, të kontribuojë në përfundimin e rolit të Komunës, OJQ-ve dhe komunitetit në ruajtjen dhe re vitalizimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe shfrytëzimin e saj të qëndrueshëm në shërbim të zhvillimit lokal. Objektivi tjetër kryesor është njoftimi dhe bashkëpunimi me të gjithë akterëve të nivelit qendror, komunal dhe të komunitetit vendas që operojnë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

**OBJEKVI 1-rë:** Njoftimi me kornizën ligjore dhe institucionale

- Informimi i qytetarëve me legjislacionin ligjor dhe aktet tjera ligjore të trashëgimisë kulturore të Kosovës;
- Zbatimi efektiv i legjislacionit për trashëgiminë kulturore;
- Zhvillimi i institucioneve të trashëgimisë kulturore (përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe teknike të institucioneve të trashëgimisë kulturore);
- Reformimi dhe rrijtëzimi i institucioneve të trashëgimisë kulturore.

**OBJEKTIVI 2-të:** Qasja e integruar në trashëgiminë kulturore, drejt zhvillimit të qëndrueshëm

- Partneriteti me institucionet homologe në Kosovë dhe më gjerë.

**OBJEKTIVI 3:** Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet zhvillimore komunale

- Me një kujdes të veçantë nga ekspertët e fushës së turizmit dhe trashëgimisë kulturore të analizohen potencialet e trashëgimisë kulturore dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit që ka Deçani, si dhe të përfshihen mirë dhe saktë trashëgimia kulturore në Planin zhvillimor Komunal të Deçanit.

**OBJEKTIVI 4:** Promovimi i trashëgimisë kulturore në Komunën e Deçanit

- Përmes organizimit të aktiviteteve kulturore dhe fushatave të ndryshme në media, të cilat organizohen dhe mund të organizohen në komunën tonë.
- Shënjimi në rrugë dhe i objekteve kulturore në Komunën e Deçanit.
- Krijimi data bazës me të dhëna për trashëgiminë kulturore të Deçanit.

**OBJEKTIVI 5:** Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e të gjithë akterëve

- Trajnime të ndryshme, me qëllim edukimi të të gjithëve për pasuritë, mundësitë dhe pengesat që janë në këtë mision.
- Seminare aftësuese me pronarët dhe të interesuarit për projekte e ndryshme;
- Takime formale me akterët e ndryshëm;
- Organizimi i fushatave informuese me qytetarë;
- Inventarizimi dhe digjitalizimi i trashëgimisë kulturore;

- Mirëmbajtja dhe avancimi i të dhënave;
- Plotësimi i listës së MKRS me kategorinë e trashëgimisë monumentale, shpirtërore dhe kulturore nga komuna jonë;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e Listës së Përkohshme dhe krijimi i Regjistrat Komunal;

## 5. TRASHËGIMIA KULTURORE NË DEÇAN, ANALIZA SWOT

Gjendja e trashëgimisë (objekteve) kulturore në komunën e Deçanit duhet vështruar, identifikuar dhe analizuar me kujdes, ajo duhet të harmonizohet dhe të përfshihet në planin zhvillimor komunal, me qëllim ruajtja, promovimi dhe shfrytëzimit i saj. Po ashtu përgatitja e këtij plani për trashëgiminë kulturore ka një rëndësi të madhe. Për të njohur më mirë gjendjen e trashëgimisë kulturore në Deçan, për të organizuar mbrojtjen, promovimin dhe shfrytëzimin e saj, është bërë analiza SWOT. Kjo metodë vlerësimi është përdorur gjatë punës së kësaj ekipe.

### ANALIZA SWOT

Në punëtorinë e organizuar nga grupi punues është hartuar SWOT analiza.

SWOT analiza e hartuar nga grupi punues ka shërbyer si mjet për definimin e objektivave kryesore për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunën tonë.

***Përparësitë – atributet pozitive të brendshme,***

***Dobësitë – atributet negative të jashtme,***

***Mundësitë – faktorët e jashtëm të cilët mund të përmirësojnë gjendjen,***

***Rreziqet – faktorët e jashtëm të cilët mund të rrezikojnë gjendjen.***

Puna e grupit punues do të prezantohet me këto të dhëna:

#### **Përparësitë:**

- Pozita gjeografike dhe klima e volitshme,
- Resurset kulturore, natyrore dhe njerëzore
- Lokalitet i pasur me trashëgimi arkitekturore: Kullat e gurit trashëgimi arkitekturore e veçantë.
- Objektet fetare: xhamitë, manastiri i Deçanit, mullinjtë me ujë etj.
- Trashëgimia arkeologjike: gjetjet e rastit, lokalitetet e mundshme arkeologjike të evidentuara.
- Organizimi tradicional i aktiviteteve - ngjarjeve tradicionale kulturore.

#### **Dobësitë:**

- Mungesa e planeve zhvillimore për trashëgiminë kulturore
- Mos përcaktimi i zonave të mbrojtura
- Mungesë e ekspeditave hulumtuese në fushën e arkeologjisë
- Mungesa e hapësirave për zhvillimin e turizmit kulturor, nuk shfrytëzohen objektet kulturore.
- Zhdukja e artizanateve të vjetra dhe tradicionale,
- Migrimi i të rinjve jashtë vendit.

**Mundësitë:**

- Zhvillimi i rrjetit për turizëm kulturor brenda dhe jashtë komunës sonë
- Zhvillimi i ekonomisë lokale duke shfrytëzuar potencialit e trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- Përkushtim më i madh i qeverisë lokale për ruajtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore
- Tërheqja e investimeve vendore (MKRS, MZHE) dhe të huaja (OJQ-ve ndërkombëtare).
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore në fushën e trashëgimisë kulturore
- Organizimi (traditë e mirë) i aktiviteteve kulturore.

**Kërcënimet/rreziqet:**

- Gjendja e rëndë ekonomike
- Mosdefinimi i zonave të mbrojtura dhe përgjegjësive institucionale
- Ndërtimet e egra (në zonat e mbrojtura) dhe zhvillimet e pakontrolluara
- Mosrespektimi i ligjeve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore
- Mospërfshirja e të gjitha objekteve në listën për mbrojtje të përkohshme
- Investime të vogla në infrastrukturë (objektet kulturore)
- Përkrahja e vogël për pronarët e objekteve kulturore
- Përkrahja jo e mjaftueshme për OJQ-t që merren me fushën e trashëgimisë kulturore.

## 6. TRASHËGIMIA KULTURORE NË KOMUNËN E DEÇANIT

Trashëgimia kulturore është trashëgimi fizike e artefakteve dhe objekteve të një grupi ose të shoqërisë të cilat janë të trashëguara nga gjeneratat e kaluara tek gjeneratat e tashme me qëllim të kujdesit për të mirën e brezave të ardhshëm.

Trashëgimia kulturore përfshinë kulturën materiale (ndërtesat, monumentet, peizazhet, librat, veprat e artit dhe objektet e ndryshme), dhe kulturën shpirtërore, (folklorin, traditat, gjuhën dhe ngjarjet tjera tradicionale), si dhe trashëgiminë natyrore (duke përfshirë peizazhet e rëndësishme kulturore).

Deçani është një prej qyteteve më të pasura me trashëgimi kulturore-historike në Kosovë.

Trashëgimi, kjo, që shprehet në formën e saj ndërtimore – monumentale dhe shpirtërore.

*Trashëgimia arkeologjike dhe arkitekturore.* Në Deçan kemi disa lokalitete të mundshme arkeologjike (ato tani për tani janë vetëm të evidentuara), objektet fetare - xhamitë dhe manastirin, objektet e banimit-kullat e gurit, mullinjtë me ujë, si dhe monumente tjera me rëndësi historike - lapidaret në përkujtim të dëshmorëve dhe historisë sonë të lavdishme gjatë luftës së fundit të UÇK-së (1998-1999).

*Trashëgimia shpirtërore:* Muzika: Kënga me lahutë, malësorçe, kënga folklorike, kënga e vajzave. Vallja tradicionale. Ritët e vdekjes dhe gëzimit - martesës (dasma tradicionale).

Humori tradicional i odës (anekdotat dhe meseletë e burrave).

*Institucionet e kulturës dhe organizimet tjera kulturore:* Muzeu Etnologjik, Arkivi Komunal.

Ansambli KV “Deçani”, Grupi Folklorik “Dervish Shaqa”, SHKA “Jusuf Gërvalla”.

*Zejet tradicionale:* Punimi i drurit: Punimet dekorative me dru dhe Punimi i veglave muzikore tradicionale, Punimi i gurit (mjeshtrit e gurit), Punimi artizanal i veshjeve kombëtare.

*Ngjarjet kulturore,* Festivali i folklorit “Eshkë e ndezur mbi Shkëlzen”, Festivali i Lahutës, Darka e lamës, Dita e gështenjës, Panairi i produkteve vendore, etj.

*Ushqimi tradicional,* prodhimet vendore etj.

## **7. LISTA ME OBJEKTET E TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOMUNËN E DEÇANIT, QË JANË NËN MBROJTJE TË PËRKOHSHME NGA MKRS**

**Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme në Kosovë për vitin 2022-2023 (10.10.2022,MKRS), e cila listë përmban gjithsej 1638 asete të trashëgimisë kulturore. Prej tyre, nga Komuna e Deçanit, janë: 11 asete në kategorinë trashëgimia arkeologjike, 56 asete në kategorinë trashëgimia arkitekturore, ndërsa 2 në kategorinë peizazhet kulturore.**

Në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përhershme (26.06.2023, MKRS), gjendet Manastiri i Deçanit (me nr. 3106).

### **Antikë dhe mesjetë:**

- Lokaliteti arkeologjik i periudhës romake në Irzniq Romake,
- Tuma e vetmuar në Irzniq, Parahistori,
- Fortifikim parahistorik, Baballoq,
- Lokaliteti arkeologjik parahistorik, Baballoq,
- Fortifikim i Antikitit të Vonë në Strelc, Strelc i epërm,
- Lokaliteti arkeologjik në Romake - Antikë e Vonë, Rastavicë
- Kalaja antike në Belle Antikiteti i Vonë Belle,
- Murgorja e Zojës së Bekuar në Belle, Mesjetë Belle,

### **Arkitektura**

#### **Objektet e kultit:**

- Xhamia e Deçanit Shek. XIX, Deçan,
- Xhamia e Pozharit Shek. XVIII, në Pozhar,
- Mejtepi në fshatin Llukë e Epërme Shek. XIX Llukë e Epërme,
- Xhamia e Drenocit Shek. XX, në Drenoc,
- Xhamia e Carrabregut 1816, në Carrabreg,
- Xhamia e Isniqit Shek. XVII, në Isniq,
- Xhamia e Lëbushës 1793, në Lëbushë,
- Xhamia e Vokshit 1866 në Voksh,
- Xhamia e Baballoqit 1868, në Baballoq,

#### **Objektet në mbrojtje të përhershme (MKRS):**

- Manastiri i Deçanit, shek. XIV, në Deçan (nën mbrojtje të UNESCO-s).

#### **Kullat si Objekte nën mbrojtje të përkohshme:**

1. Kulla e Zymer Himës, Shek. XVIII, Deçan
2. Kulla e Demukajve, Shek. XIX, Deçan
3. Kulla e Ramë Shabanit, Shek. XIX, Prapaqan
4. Kulla e Haxhi Osë Miftarit, Shek. XIX, Isniq
5. Kulla e Ramiz Kuklecit, Shek. XIX, Isniq
6. Kulla e Kuklecve, Shek. XVIII, Isniq
7. Kulla e Musë Mehmetit, Shek. XIX, Isniq
8. Kulla Smajl Nimon Balaj, Shek. XIX, Isniq

9. Kulla e Zenun Ahmetit, Shek. XIX, Isniq
10. Kulla e Sali Gecës, 1800, Isniq
11. Kulla e Mujë Mehmetit, Shek. XIX, Isniq
12. Kulla e Sadik Ibishit, Shek. XIX, Isniq
13. Kulla e Sylë Tahirsylaj, Shek. XIX, Isniq
14. Kulla e Adem (Qerim) Osdautaj, Shek. XVIII, Isniq
15. Kulla e Tafë (Hysen) Maksutaj, 1870, Isniq
16. Kulla e Demë Ali Pozharit, Shek. XIX, Pozhar
17. Kompleksi i Kullave në lagjen Mazrrekaj, Shek. XIX, Drenoc
18. Kulla e Tahir Baqit, Shek. XIX, Drenoc
19. Kulla e Ali Gecit, Shek. XVIII, Llukë e Ulët
20. Kulla e Florim Januz Gecaj, Shek. XIX, Llukë e Ulët
21. Kulla e Muhamet Dervish Çekaj, Shek. XIX, Irzniq
22. Kulla e Zymer Fetës, Shek. XIX, Irzniq
23. Kulla e Shaban Murat Gjokaj, Shek. XIX, Strellci i Ultë
24. Kulla e Bajram Qerim Istrefaj, Shek. XIX, Strellci i Epërm
25. Kulla e Reshat Istrefaj, Shek. XIX, Strellci i Epërm
26. Kulla e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës, Shek. XX, Dubovikë
27. Kulla e Donikë Jusuf Gërvallës, Shek. XX, Dubovikë
28. Kulla e Hasan Mehmetit, Shek. XIX, Dubovikë
29. Kulla e Azem Ramë Lokaj, Shek. XIX, Voksh
30. Kulla e Miftar Alisë, Shek. XIX, Lumbardh
31. Kulla e Bajram Xhafer Lekaj, Shek. XIX, Lumbardh
32. Kulla e Hamëz Mataj, shek. XIX, Baballoq,
33. Kulla e Gjyle Kadrijaj, Shek. XIX, Rastavic
34. Kulla e Himë Nimonit, Shek. XIX, Pobërgjë
35. Kulla e Haxhë Alisë, Shek. XIX, Pobërgjë
36. Kulla e Ali Jusuf Mataj, Shek. XIX, Pobërgjë
37. Kulla e Ali Avdijaj, Shek. XIX, Gramaqel
38. Kulla e Ramë Stojkaj, Shek. XIX, Lloqan
39. Kulla e Ali Ozmanit, Shek. XIX, Broliq
40. Kulla e Ramë Shabanit, Shek. XIX, Prapaçan
41. Çardaku i Azem Hamzë Ahmetaj, Shek. XIX, Lëbushë.

### **Mullinjt me ujë:**

- Mulliri i Tahirsadrive Shek. XIX, Isniq
- Mulliri i Shabanajve Shek. XIX, Deçan
- Mulliri i Gjokokajve, Shek. XVIII, Deçan,
- Mulliri i Beqir Halil Haxhosaj, Shek. XIX, Prokolluk
- Mulliri i Sadik Berishës, Shek. XIX, Irzniq
- Mulliri i Cufë Smajlit, Shek. XIX, Rastavicë,
- Mulliri i Avdyl Zenel Jasiqi, Shek. XVIII, Gramaqel
- Mulliri i Daut Osë Hulaj, Shek. XIX, Hulaj
- Mulliri i Avdyl Lulaj, Shek. XIX, Broliq



**Objekte tjera me rëndësi historike:**

- Kompleksi i Dëshmorëve Shek. XX, Gllogjan
- Shtabi i Zonës Operative të Dukagjinit Shek. XX, Gllogjan
- Shkolla e parë shqipe në Strelc të Epërm 1907, Strelc i Epërm

**Peizazhet kulturore:**

- Blini në Rastavicë Shek. XVIII, Rastavicë,
- Verrat e Llukës, Llukë e Epërme
- Objekt i veçantë kulturor:
- Koshi i drithit - Enver Likaj, shek.XIX Carrabreg i Ulët.

**Asetet kulturore që propozohen nga plani që të jenë pjesë e listës nën mbrojtje:**

Në këtë listë bëjnë pjesë: Objekte me rëndësi kulturore dhe historike, zeje tradicionale, institucione kulturore, aktivitete - ngjarje tradicionale kulturore, trashëgimia shpirtërore, ushqimet tradicionale etj.

**Objektet e evidentuara që nuk janë nën mbrojtjen e listës së MKRS:**

1. Kulla e dëshmorëve në Prejlep
2. Kulla e Pajtimit në Lumbardh

**-Institucionet kulturore (institucionet zyrtare - lokale dhe OJQ kulturore)**

1. Arkivi komunal
2. Muzeu Etnologjik në Deçan
3. Kompleksi memorial i dëshmorëve të UÇK-së – Kulla Muze në Gllogjan
4. Kompleksi memorial –Shtabi i UÇK-së ZOD në Gllogjan
5. Kulla Muze e Jusuf Gërvallës në Dubovikë
6. Qendra rinore dhe Kolonia e artistëve
7. Ansambli “Deçani”
8. Grupi i folklorit “Dervish Shaqa”
9. SHKA “Jusuf Gërvalla”

**-Ngjarjet (aktivitetet) kulturore:**

1. Festivali gjithëkombëtar i folklorit “Eshkë e ndezur mbi Shkëlzen”
2. “Festivali i Lahutës”
3. “Darka e Lamës”
4. Riti tradicional “Çethja e deleve”
5. “Dita e Gështenjës”
6. Panairi i produkteve vendore

**-Trashëgimia shpirtërore:**

- Këngët folklorike (melosi rekçe)
- Këngët me lahutë
- Këngët malësorçe

Këngët e bjeshkës  
Këngët e kanagjeqit  
Këngët e vajtimit  
Vallja 2-she tradicionale e Deçanit  
Ritët e martesës (dasma tradicionale)  
Këngë me kapuçë  
Humori tradicional i odës (anekdotat dhe meseletë e burrave)

**-Zejet tradicionale:**

1. Punimi i drurit:
2. Punimet dekorative me dru
3. Punimi i veglave muzikore tradicionale
4. Punimi i gurit (mjeshtrit e Gurit)

**-Punimi artizanal i veshjeve kombëtare**

1. Veshja e grave (katundit) të Deçanit

**-Ushqimi tradicional dhe produktet vendore**

## **8. PRIORITETET SIPAS PLANIT**

Pas analizës gjithëpërfshirëse, si komision dhe në konsultim me të tjerët, kemi arritur që të përpilojmë prioritetet e këtij plani, ato janë:

1. *Identifikimi i objekteve dhe lokaliteteve me rëndësi kulturore,*
2. *Mbrojtja e tyre nga rreziqet e mundshme,*
3. *Shfrytëzimi i drejt i tyre në të mirë të komunitetit vendas,*
4. *Promovimi i trashëgimisë kulturore përmes organizimit të aktiviteteve kulturore.*

**1. Identifikimi i objekteve dhe lokaliteteve me rëndësi kulturore**

- a. Ekspedita evidentimi, hulumtuese dhe studimore
- b. Shënjimi i objekteve kulturore.

**2. Mbrojtja e tyre nga rreziqet e mundshme**

- a. Respektimi i rregulloreve dhe ligjeve në fuqi
- b. Vetëdijesimi i pronarëve dhe qytetarëve, përmes trajnimeve të ndryshme.

**3. Shfrytëzimi i drejt i tyre në të mirë të komunitetit vendas**

- a. Shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve infrastrukturore dhe atyre njerëzore
- b. Përkrahje me projekte zhvillimore
- c. Organizimi i Projekteve të ndryshme kulturore.

#### **4.Promovimi i tyre**

Promovimi i aseteve të trashëgimisë kulturore bëhet me qëllim të ruajtjes dhe të rritjes së Turizmit kulturor, e kjo arrihet përmes:

- a. Organizimit të ngjarjeve kulturore
- b. Organizimi i guidave turistike
- c. Organizimi i ngjarjeve kulturore si dhe shfrytëzimi i objekteve kulturore si vend takime në: promovim librash, organizim i ekspozitave, shfaqje filmash dhe shfaqjeve teatrale.

### **9. MASAT REKOMANDUESE SIPAS PLANIT**

Rekomandimet që dalin nga ky plan, Organet Zyrtare dhe përgjegjëse, për pronarët, shfrytëzuesit dhe qytetarët tjerë në raport me objektet me vlera kulturore dhe historike.

Si grup punues kemi disa rekomandime për të tjerët, që dalin si obligime të menjëhershme dhe të nevojshme, siç janë:

1. *Identifikimi i objekteve me vlera kulturore- historike dhe me vlera turizmi*
2. *Ruajtja dhe mbrojtja e objekteve me rëndësi për trashëgiminë kulturore*
3. *Kapitali njerëzor*
4. *Shfrytëzimi i objekteve kulturore*
5. *Masat për mbrojtjen e objekteve me vlera kulturo-historike*
6. *Promovimi i objekteve dhe fshatrave (rajonit) me rëndësi për trashëgiminë kulturore.*

#### **9.1.Identifikimi i objekteve me vlera kulturore - historike dhe vlera turizmi**

-Detyra: Puna dhe aktiviteti i përhershëm në identifikimin e objekteve, lokaliteteve me vlera të rëndësishme për kulturën tonë.

-Përpilimi i një liste më gjithëpërfshirëse të objekteve të trashëgimisë kulturore me rëndësi kulturore dhe historike në Komunën e Deçanit.

-Shënjimi si një prioritet që informon, identifikon dhe edukon me qëllim të ruajtjes, promovimit të objekteve të trashëgimisë kulturore.

##### **Akterët:**

-Organet zyrtare - komunale të kulturës, QRTK, MKRS dhe të tjerët.

#### **9.2. Ruajtja dhe mbrojtja**

-Kontrollimi i terrenit më qëllim që të shihet nga afër:

-Shënjimi, futja në listë të mbrojtjes (L.P. MKRS) lista në nivel komune.

-Të planifikohet ku janë mundësitë të konservohen, të presin investimet për renovime

-Të llobohet vazhdimisht me fushata vetëdijesuese për ruajtjen e trashëgimisë kulturore

-Me trajnime, fletushka, reklama, video promovuese dhe aktivitetet tjera

-Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve të R. Kosovës në raport me trashëgiminë kulturore

-Të kontrollohen dhe të ndalohen ndërtime, zhdukja e objekteve ekzistuese, shfrytëzimi dhe aktivitetet që organizohen ndërkohë në terren.

##### **Akterët:**

-DKRS dhe OJQ-të e ndryshme, pronarët e aseteve (objekteve) kulturore dhe të tjerët.

-Inspektorët sanitar, ambientit, dhe Inspektorati Qendror (MKRS).

### **9.3. Kapitali njerëzor**

- Pronarët dhe të tjerët- njoftimi i tyre me pasuritë që kemi si komunë,
- Informimi i tyre përmes aktiviteteve dhe kampanjave të ndryshme,
- Trajnimi i tyre për projektet dhe mundësitë: që kemi si komunë.

#### ***-Përmes trajnimeve të ndryshme biznesore:***

- Trajnime me temën “Ruajtja e trashëgimisë kulturore”
- Trajnime me temën “Promovimi i trashëgimisë kulturore”
- Trajnime me temën “Shfrytëzimi i objekteve të trashëgimisë kulturore”
- Trajnime me temën “Si të fitojmë projektet zhvillimore dhe financiare në fushën e trashëgimisë kulturore dhe turizmit”.

### **9.4. Shfrytëzimi i objekteve kulturore**

- Përkrahja e akterëve (pronarëve të aseteve dhe iniciativave për zhvillimin e turizmit),
- Përmes: fondeve për restaurim, trajnim për ruajtje, shfrytëzim, zhvillim dhe promovim
- Ndarja e fondeve për zhvillimin e turizmit rural
- Ndarja dhe përcjellja e investimeve për restaurim të monumenteve kulturore

### **9.5. Masat për mbrojtjen e objekteve me vlera kulturo-historike**

- Vlerat e mbrojtura të kulturës dhe historisë mund të përdoren dhe shfrytëzohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjatë, në përputhje me Ligji Nr.

Për mbrojtjen e Natyrës.

- Në pjesën e mbrojtur të natyrës nuk mund të zhvillohen aktivitete të cilat e rrezikojnë vlerat kulturore ose në çfarëdo mënyrë degradojnë cilësitë dhe veçoritë e vlerave kulturore.

- Çdo punë për modifikim ose demolim ose ndonjë veprim konservues apo restaurues kërkon pëlqim me shkrim nga Institucioni kompetent.

- Trashëgimia arkitekturale nën mbrojtje shënjohe qartë me një shenjë të dukshme.

- Gërmimet arkeologjike mund të bëhen vetëm me lejen e shkruar të Institucionit Kompetent (komunës, QRTK-Pejë, MKRS).

- Trashëgimia kulturore shpirtërore në formë të ndryshme të dokumentimit dhe të regjistrimeve mbrohet, ruhet dhe promovohet në pajtim me këtë ligj dhe Parimet ndërkombëtare, standardet dhe praktikat gjyqësore.

- Komuna, së bashku me Institucionet e nivelit Qendror duhet të përgatisin planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore.

### **9.6. Promovimi, Fushata promovimi, takime me qytetarë**

- Promo në Gazeta, radio dhe TV të ndryshme të Kosovës,

- Reklama promovuese nëpër rrjete sociale dhe media

- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme tradicionale, të bëhen tradicionale dhe të zyrtarizohen sipas një kalendarit vjetor (për kalendarin do të vendos DKRS me akterët tjerë brenda komunës).

- Përmes kampanjave dhe trajnimeve të ndryshme të sqarohen mundësitë për shfrytëzimin e objekteve kulturore si dhe zhvillimin e turizmit rural.

- Gara me nxënës.

## **10. MIRATIMI, REALIZIMI, ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT**

**Miratimin** e Planit për Trashëgiminë kulturore të Deçanit 2024-2028, e bën Kuvendi Komunal i Deçanit.

Ky plan është i fokusuar në objektiva reale dhe lehtë e matshme për Deçanin, përmbushja e këtyre kriterëve është parakusht për realizimin e qëllimit të përgjithshëm për identifikimin, promovimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

### **Realizimi i planit:**

Ky plan i punës, duhet të praktikohet dhe të realizohet nga Komuna e Deçanit, DKRS, dhe përmes organizmave të ndryshme kulturore në Komunën tonë, gjithmonë në bashkëpunim me OJQ-të vendore e ndërkombëtare.

-Zyra e Kryetarit, DKRS dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, janë përgjegjës për zbatimin e këtij plani.

-Përkrahja financiare, duhet të vijë nga MKRS, Komuna e Deçanit dhe donatorë tjerë të mundshëm.

-Organizimin e aktiviteteve e marrin përsipër Zyra e Kryetarit, DKRS dhe OJQ-të në komunën e Deçanit.

### **Zbatimin i planit:**

-Zyra e Kryetarit dhe DKRS, janë të obliguara për zbatimin e këtij plani.

### **Monitorimi i planit:**

Gjithsesi, aktivitetet kulturore me qëllim të realizimit të këtij plani do të monitorohen nga Komisioni për Trashëgimi kulturore i formuar nga Kuvendi komunal në bashkëpunim me QRTK në Pejë.

## **11. NDIKIMI FINANCIAR I PLANIT**

DKRS, në bashkëpunim me komisionin komunal për Trashëgimi Kulturore i themeluar nga kuvendi Komunal i Deçanit, se pari:

1. Evidenton objektet me rëndësi kulturore dhe historike.
2. Harton një listë me prioritet të objekteve që duhet dhe mund të investohet.
3. Po ashtu me anën e ekspertëve komunal harton projekte për investime të mundshme në fushën e trashëgimisë.
4. Kërkon nga buxheti komunal ((Komuna), adreson projekt dhe kërkesa për intervenimet emergjente në objektet kulturore.
5. Orienton punën dhe aktivitetet me QRTK-Pejë, MKRS dhe OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare si dhe me pronarët e aseteve kulturore dhe akterët tjerë lokal në fushën e trashëgimisë kulturore në Deçan.

## **12. GJENDJA FIZIKE E OBJEKTEVE KULTURORE NË KOMUNËN E DEÇANIT**

Objektet e trashëgimisë kulturore në nivel komune, në një masë të vogël shfrytëzohen për qëllime kulturore, e shumë më pak për qëllime përfitimi nga pronarët e tyre dhe komuniteti. Deri sa shumica

e objekteve kulturore edhe pse janë restauruar gjatë kësaj kohe, rrezikohen dhe dëmtohen dita e ditës nga shumë faktorë, si nga faktori njeri dhe kohë. Andaj, në këtë plan kemi prezantuar gjendjen reale, dobësitë dhe sfidat e vazhdueshme në terren, siç janë:

1. Nevoja për intervenim në restaurimin e tyre (të objekteve që kanë nevojë për restaurim) e trashëgimisë kulturore,
2. Mungojnë investimet e vazhdueshme në mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre,
3. Shfrytëzimi jo adekuat (i dëmshëm) i objekteve me rëndësi të veçantë,
4. Shfrytëzimi i vogël i objekteve të trashëgimisë përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore.

### **13. LISTA E AKTIVITETEVE KULTURORE TRADICIONALE NË FUSHËN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOMUNËN E DEÇANIT**

**-Disa nga Ngjarjet – aktivitetet kulturore që organizohen tradicionalisht në komunën e Deçanit, janë:**

1. Festivali gjithëkombëtar i folklorit “Eshkë e ndezur mbi Shkëlzen”
2. “Festivali i Lahutës”
3. “Darka e Lamës”
4. Riti tradicional “Çethja e deleve”
5. “Dita e Gështenjës”
6. Panairi i produkteve vendore.

### **14. REZULTATET E PRITURA TË PLANIT**

Rezultatet që presim nga miratimi dhe zbatimi i këtij plani, janë:

- Obligim shtesë i institucioneve përgjegjëse komunale të kulturës,
- Informim më i detajuar – drejtë i Kuvendit Komunal rreth zhvillimeve në fushën e trashëgimisë kulturore,
- Hyrja në obligime e komunës, të organizimit të aktiviteteve tradicionale, kjo përmes publikimit të kalendarit zyrtar,
- Bashkëpunim më i afërt me pronarët e objekteve të trashëgimisë kulturore,
- Informim më i drejt i qytetarëve për vlerat kulturore që ka komuna e Deçanit,
- Shfrytëzim më i mirë i objekteve kulturore në Deçan,
- Përmirësim më e mirë i gjendjes fizike i objekteve kulturore.

### **15. EKIPI I PUNËS**

**Dr.sc.Bekim Vishaj**  
**Arch.Shkëlzen Shehu**  
**Ma.Arjan Dobraj**  
**Ecc.Skender Kurmehaj**  
**Arch.Leotrim Hadergjonaj**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural 08 Nr. \_\_\_\_\_ /2024 Dt. 16 / 02 /2024

<b>Për</b>	<i>Anëtarët e Kuvendit Komunal në Deçan.</i>
<b>Nga</b>	<i>Rifat Stojkaj – Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Deçan</i>
<b>Përmes</b>	<i>z. Bashkim Ramosaj – Kryetar i Komunës së Deçanit</i>
<b>Lënda</b>	<i>Kërkesë</i>
<b>Datë</b>	<i>16/02/2024</i>

Të nderuar,

Duke qenë se Komuna e Deçanit deri me tani ka përkrahur mbi 400 fermerë me Mekanizëm Bujqësor dhe mbi 100 fermerë të tjerë në lëmin e Blegtorisë duke i shpërndarë 100 Mëshqerra Barrëse të racës Hollshtajn Frizis, tani synim i yni është përkrahja e fermerëve lavërtarë në ngritjen e serrave dhe bletarët me mekanizëm bujqësor, në bashkëfinancim me organizata joqeveritare dhe qytetarë.

Komuna e Deçanit, përmes projektit për ngritjen e serrave për kultivimin e perimeve synon t'i përkrah mbi 50 fermerë në prodhimtari bujqësore në fusha të hapura, përkrahje kjo që fermerët tanë do t'i ndihmonte në sigurimin e perimeve për konsum të tyre familjar si dhe një pjesë tjetër për ta nxjerr në treg me çka fermerët përfitues do të siguronin vetëpunësim si dhe gjenerim të mjeteve financiar për t'i rritur kapacitetet në prodhimtari bujqësore në të ardhmen.

Duke besuar në arsyeshmërinë e kësaj kërkesë, kërkojmë nga ana juaj ndarjen e 20.000 Eurove për bashkëfinancim me organizata joqeveritare dhe qytetarë për realizimin e këtij projekti.

